



PROCESVERBAL III/2023

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 3 (tretë) për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 30.03.2023
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci
Z.Selman Kolgeci

Z. Flamur Bytyçi

Z. Urim Suka

Z. Kushtrim Kuçi

Znj. Elmaze Bytyqi

Znj. Bulëza Kuçi

Znj.Doruntina Zenelaj

Z.Alban Berisha

Z. Bexhet Kuçi

Z. Reshat Selimaj

Z. Lirim Qatani

Z. Aziz Bytyqi

Znj.Sanie Kuçi-

Rexhepaj

Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina

Z. Vullnet Luzhnica

Z. Xhevshet Gashi

Z.Edon Sadikaj

Znj.Saranda

Bajraktari

Znj.Mimoza Bajraktari

Znj.Festë Kabashi

Z.Dardan Berisha

Z.Bajram Basha

Znj.Mevlude Kabashi

Znj.Sheqerije Zyrapi

Znj.Laureta Tafaj

Z.Liridon Fandaj

Z.Qëndrim Elshani

Z.Herolind Limaj

Znj.Jehona Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari i Komunës

Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2022,të barten në shfrytëzim në vitin fiskal 2023 ;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e xhamisë në Shirokë**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për mbikqyrjen e zbatimit të kontratave për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të Komunës nga përfituesit;**
- 5. Njoftim i planit të zyrës së prokurimit për vitin 2023;**
- 6. Raporti i punës për zyrën e prokurimit për vitin 2022;**
- 7. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2022,të barten në shfrytëzim në vitin fiskal 2023 ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Flamur Bytyçi - te tabela nr.1 nuk po e kuptoj si ka dalë vlera 635.000 euro.Mendoj që është bërë gabim sepse nuk e keni llogarit një vlerë të 5.000 eurove.Kërkoj sqarime.

Labinot Halitjaha - ky 5.000 euro është gabim teknik që ka qenë dhe në KPF por nuk qenka përmirësu nga zyrtari kryesor financiar.

Flamur Bytyçi - d.m.th vlera është 640.000.

Labinot Halitjaha - është 635.000,por kjo është vlerë e investimeve kapitale ku del edhe në pjesën tjetër mbrapa por që nuk është përmirësu.

Laureta Tafaj - bartje e mjeteve çdo vit te Koletori.Besoj e dini që Ministria e Infrastrukturës e ka atë pjesë të rrugës.Cka do të bëni me atë Kolektor?A po mendoni veq me i fut mjetet për kolektor e pastaj ti shpërndani ku të doni ju.Kërkoj një përgjigje.

Kryesuesi - besoj që një procedurë që nisat,do të kryhet.

Laurtea Tafaj - besoj që kryhet por nuk na takon neve.

Kryesuesi - meqenëse ekzekutivi i ka parapa mjetet,edhe ne si Komunë kujdesemi për atë rrugë.

Urim Suka - projekt-vendimi për bartjen e mjeteve për vitin 2023 është e vërteta e këtij pushteti dhe nxjerr zbuluar propagandën masive të tij.Rreth 1 milion euro edhe zyrtarisht ju kanë mbetur pa shpenzuar.E vërteta është që ka bartje të mjeteve nga viti në vit por ka një dallim dhe ajo është që në kohën tonë,kritika për bartje ishte vetëm për 350.000 euro ndërsa kritika sot është rreth 1 milion euro.Kjo tregon të vërtetën tuaj që nuk ka asgjë të përbashkët me propagandën masive që ju bëni përmes facebook-ut e portaleve.Meqenëse keni kritikuar pushtetin e LDK-së për bartjen e 350.000 eurove,çka do të thoni tani për këtë vendim që e keni sjell?A është gabim bartja e 1 milion eurove nga viti në vit apo jo?A është paaftësi e juaja qeverisëse?A është mashtrim e propagandë gjithë kjo logjikë qeverisëse?

Në këtë vendim ju keni ndarë 10.000 euro për ndërtimin e rrugëve në Gjinoc.Në mesin e rrugëve të planifikuara është edhe rruga”Sherif Aga”,mirëpo kjo rrugë është në kontratë të viti 2022.Gjithëashtu figuron për ndërtim edhe në planifikimin e buxhetit për vitin 2023,ndërsa tash prap figuron edhe në këtë vendim që keni sjell për bartje. Në këtë vendim keni planifikuar 13.178 euro për ndërtimin e rrugëve në Mushtisht por e vërteta është që këto rrugë kanë qenë në kontratë të vitit 2022 dhe nuk janë shtruar fare dhe në raportin e kontratave që ju keni sjellë figuron që janë paguar 72.000 euro për këto rrugë mirëpo rrugët nuk janë shtruar.Këto rrugë përveq që sjanë shtruar,ju i keni në planifikim edhe në buxhetin e vitit 2023 ndërsa tash në këtë vendim po planifikoni prap mjete për këto rrugë.Në këtë projekt-vendim për bartje ju keni planifikuar 200.000 euro për ndërtimin dhe sanimin e rrugëve lokale Sopijë-Vraniq dhe Reqan-Bukosh.Problemi është që ju keni një kontratë prej 250.000 euro për ndërtimin dhe sanimin e rrugëve.Për vitin që shkoi ju i keni shpenzuar 124.000 euro dhe 126.000 euro ju i keni në dispozicion dhe mundeni me fillu menjëherë sanimin e rrugëve në fjalë.Por më e çuditshmja është se ju keni planifikuar edhe 200.000 euro për vitin 2023 për këto rrugë.Një sqarim e keni dhënë në KPF ku thatë që këto rrugë do të shtrohen nga fillimi.Nëse kjo është e vërtetë,më lejoni të ju kujtoj që rruga Reqan-Bukosh ka 4-5 vite që e keni shtru dhe sot po planifikoni ta shtroni rishtazi.Kjo tregon për cilësinë e punimeve tuaja dhe kjo dëshmon që kjo qeverisje lokale nuk kalon e rjedhimisht as ky vendim si i tillë nuk duhet të kaloj.Prandaj jemi kundër këtij vendimi dhe si të tillë e votojmë kundër.

Kryetari - Lauretë e dini që e kemi kalu PZHK-në dhe HZK-në.Suharekë është deri në autostradë.Lënda është në ri-vlerësim dhe kur të kryhet,ju premtoj që Kolektori do të kryhet.Sa i përket Urimit,është mirë me qenë më konkret,me fol me argumente dhe jo pa argumente.Suficit Komuna jonë ka pas 37.000 euro.Të hyrat që mbledhen në nëntor dhe dhjetor nuk shpenzohen.Te rruga Sherif Aga tenderi u shpall 2 vjeçar vitin e kaluar dhe rruga Sherif Aga është e përfunduar.Rruga Sopi-Vraniq komplet do të bëhet edhe një shtresë e asfaltit ndërsa rruga Shirokë-Mushtisht është rrugë regjionale.Bartja do të bëhet çdo vit.Nuk është mirë të flitet para qytetarëve dhe të thuhet kanë mbet 1 milion euro.Kanë mbet vetëm 37.000 euro.

Urim Suka - për të gjitha temat që unë i kam ngrit të ftoj ti vizitojmë bashkë një nga një dhe ku nuk e kam thënë të vërtetën,jap llogari.Ndërsa tash kur po flasim për bartje, ti po sillesh shumë butë por ti je ai që neve na ke kritikuar pikërisht për bartje për 350 mijë euro,dhe pyetja ime ishte a është njëjtë si mi bartë 350.000 euro dhe a është njëjtë si mi bartë 1 milion euro?Ti po thua që rruga Sherif Aga është shtruar por pse e ki në planifikim të 2023-tës dhe pse është në planifikim të bartjes?Rrugën Reqan-Bukosh ti e ke shtru dhe sot e ke sjell në vendim për ta shtruar rishtazi.Me vendimet tua e ke dëshmu që kjo qeverisje e jotja nuk kalon.

Kryetari - tenderi për rrugën Bukosh-Reqan është dhënë në vitin 2017,kanë fillu punët në 2017 dhe ka përfunduar në vitin 2018 me një shumë, shumë të vogël që ka qenë e pamundur ajo rrugë të kryhet sepse ka qenë rrugë e re komplet.Bëni dallimin 10-shi,21-shi,22-shi,bëni dallimin e mjeteve që barten dhe hyn në buxhet dhe këto shkojnë në suficit.Kodet nuk ndryshojnë.Kryetari tutje jep sqarime.

Selman Kolgeci - ne nuk kemi synim me qu në burg as Kryetarin e asnjë drejtor.Ne të kemi thënë që ti po bën matematika dhe ti nuk rrezikoshesh prej tyre.Të kemi thënë që rrezikohen zyrtarët.Sa për matje në teren,ne të kemi ftu në 3-4 seanca por s’ke dalë.Kemi kërku të formojmë komisione për secilën drejtor por s’ke dasht.Te çështja që ngriti Flamuri,a po barten 917.000 apo po barten 922.000?Nëse barten 922.000 është mirë të potencohet në vendim.A po krenohesh që po të mbesin 922.000 euro pa shpenzu?

Te çështja e Kolektorit,the që lënda është në ri-vlerësim.Lënda është anuluar dhe nuk është në ri-vlerësim dhe besoj që prap do të dal në tender.Për këtë lëndë drejtorja e Finacava ka paguar mjete dhe ne e dime që

aty nuk është punu asgjë dhe nuk kemi pa kontratë të firmosur për atë pjesë. I keni paguar rreth 1 milion euro për mësimdhënësia dhe prap nuk keni arrit me i shpenzu mjetet, prap një milion po ju mbesin.

Kryetari - 917.000 po barten. Kur ka ardhë në KPF është bërë një gabim. Asnjëherë nuk ndodh me i thënë një zyrtari nënshkruaje. Gjithkush e merr përgjegjësinë për pjesën e vet.

Selman Kolgeci - 5000 euro, a janë të llogaritura në 917.000 dhe nëse po, këtë gabim si do ta korigjoni ?

Avni Bytyqi - Zyrtari kryesor financiar pas vërejtjeve që i ka marrë në KPF për çështjen e 5000 eurove, e ka rregullu dhe ma dërgu mua në email. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Flamur Bytyqi - a ka mundësi që kjo tabelë, ky vendim që e keni sjellë me u përmirësuar dhe pastaj ne do ta votojmë.

Laureta Tafaj - të njëjtin mendim me Flamurin e ndaj edhe unë. Të përmirësohet e pastaj e votojmë. Së pari, para nxënësive dalim keq me votu me gabime. Ju lutem përmirësoni dhe të na vijë në email.

Kryesuesi - e ka përmirësuar drejtori i Financave.

Liridon Fandaj - unë e kam dhënë vërejtjen edhe në KPF për të njëjtin gabim. Ne duhet ta dim sa është vlera e saktë që ne ta votojmë bartjen e mjeteve dhe pa na ardhë në email zyrtar nuk mundemi me ditë se cila është vlera.

Shefket Kolgeci - sa mjete janë të 2021-tës dhe sa janë të 2022-tës që po barten? Duhet ta dime vlerën e saktë.

Kryetari - 2021-tës janë 380.000 euro të cilat janë bartë nga 2020-ta në 2021 dhe kanë me u bartë edhe në 2024.

Shefket Kolgeci - ne po kritikojmë Qeverinë Qëndrore që i ka blloku por Kryetar mos i bartë më, hargjoi mjetet, rregullo rrugë.

Kryetari - edhe vitin e kaluar nuk janë aprovu për tu shpenzu, edhe këtë vit nuk kanë mi lane me u shpenzu. Nuk është problemi vetëm i Suharekës.

Dardan Berisha - ky 350.000 që po e përmendin ka ndodh vetëm një vit ndërsa viteve tjera janë bartë edhe nga 1 milion e 2 milion. 10.000 euro që janë në Gjinoc, janë konkretisht për rrugë të cilat kanë fillu dhe ato duhet të përfundojnë. Me 10.000 euro ato rrugë nuk përfundojnë. Kur dalim dhe flasim në foltore e thojmë që nuk duhet me lënë as një euro bosh dhe punët duhet ti kryejë pushteti, atëherë mos të bëjmë politikë dhe mos ta keqpërdorim foltoren sepse janë mjete të qytetarëve dhe projektet duhet me arrit finalizimin. Në emër të grupit të PDK-së ne e përkrahim këtë vendim.

Urim Suka - Pse po e merr Dardani rolin e mbrojtësit të pushtetit kur e ka një hisë shumë të vogël të pushtetit. Unë nuk thashë që nuk ka mu hargju as një euro. Unë thashë që do të ketë bartje nga viti në vit por kritika që kemi pas ne nga ky Kryetar për 350.000 euro, atëherë dhe ai sot e ka sjell vendimin për me i bartë rreth 1 milion euro.

Kryetari - 936.000 euro të viti 2016 janë bartë për vitin 2017.

Dardan Berisha - hisja e qeverisë nuk ka të bëjë këtu sepse unë po flas si kuvendar i zgjedhur i qytetarëve. Bëhi koherent me vetveten dhe kthehuni pak mbrapa se qysh ka qenë.

Labinot Halitjaha - të hyrat vetanake të nëntorit dhe dhjetorit barten si te LDK-ja, si te AAK-ja. Edhe të gjykatës dhe denimeve tjera, barten. Pjesa prej 382.000 ka kalu prej vitit 2021 në 2022 të cilën e kemi votu këtu por qeveria nuk e ka miratu. Nuk e di pse bëni gjithë këtë debat, pse është çështje politike. Buxheti është rreth 19 milion.

Kushtrim Kuçi - Kryetar, kur e kemi marrë mandatin në fillim, ankesa e vetme e jotja ka qenë pandemia. Kaloi pandemia dhe pastaj fillove ta akuzosh qeverinë vetëvendosje që nuk po i lëshon parat. Gjithmonë me ankesa. Përpos rrugës Samadraxhë e cila nuk kalon dhe asnjë projekt i tij në fakt nuk kalon, çka keni pa në facebookun e tij, në punën e tyre? Kryetar i ke tri zgjidhje 1. me u marrë me ato punë që mundesh mi kry. 2. Për shkak të moshës të ka humb energjia. 3. Drejtorat nuk i ke shumë të aftë dhe fillo ndrysho diçka. 1 milion euro i ka bërë dëm buxhetit komunal Drejtoria e Arsimit dhe prap po vazhdon avazi i njëjtë. Akuza e vetme e Kryetarit Bali Muharremaj ka qenë që do ta bëjë depolitizimin e arsimit dhe ky e ka bërë krejt të kundërtën.

Kryetari - nuk jam anku asnjëherë dhe në pandemi është e vërtetë që kemi pas probleme. Drejtori e ceku që i kemi 19 milion, por jo, i kemi 30 milion euro. Sa i përket pagesave të arsimtarëve, s'është ligjore. kontrata kolektive ka marrë fund.

Liridon Fandaj - ky nuk është që nuk i ka drejtorat e mire por nuk i dëgjon.Pajtohem me Drejtorin e ekonomisë që tre mujorin e fundit mundet me mbet si të hyra të pa planifikuara por nuk kisha desh të thoni që Qeveria na ka blloku projektet.Ju i keni keqklasifiku ose keqplanifiku mjetet dhe për atë Qeveria i ka kthy. Nëse raporti yt që e ke sjell në fundvit është me suficit mbi 1 milion euro dhe Kryetari thotë që vetëm 370.000 euro kanë tepru,atëherë koordinohuni. A është duke gabu ai apo ti?

Kryesuesi - Liridon,cilin subjekt politik e përfaqëson?

Liridon Fandaj - Lëvizjen Vetëvendosje.

Kryesuesi - ne në media e kemi pa që të kanë larguar nga subjekti politikë.

Laureta Tafaj - nuk e di çka kanë shkruar mediat,por me qenë i pezulluar dhe i larguar janë dy dallime. Dy të Gjincit dhe të dy në bashkëqeverisje,si mbet puna e rrugës "Sherif Aga"?Njëri tha që është e kryer dhe tjetri tha është në gjysmë.

Kryetari - rruga "Sherif Aga" është e përfunduar.

Qëndrim Elshani - desha të bëj një kritikë.Ju jeni pjesë e KPF-së dhe pjesë e KPF-së prej LVV-së është Liridon Fandaj.Për deri sa nuk kemi kërkuar me tërhek kandidatin tone,atëherë i bie që Liridoni është pjesë e LVV-së.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

18 për,11 kundër
Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e xhamisë në Shirokë;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Laureta Tafaj - a ka ndonjë kërkesë prej qytetarëve,ndonjë listë të qytetarëve me nënshkrime të cilët pranojnë me u ndërtu ajo xhami apo është kërkesë vetëm e bashkësisë islame.

Armend Krasniqi - po,është një kërkesë e këshillit të fshatit.

Selman Kolgeci - Drejtori i Shërbimeve Pronësore dhe Juridike e ka inicu një kërkesë ku thuhet që është kërkesë e bashkësisë islame por deri më tani unë e kam pa që mungon një kërkesë e tillë.Pra ju ia keni sjellë Kuvendit një kërkesë për miratim që nuk i dimë arsyetimet e nuk e dimë as a ekziston kjo kërkesë. Ne nuk jemi kundër ndërtimit të objekteve fetare por duhet të dihet se si do të financohet.A do të ndërtohet nga donatorët e jashtëm?Nëse po,si?A do ta financojë ndërtimin e xhamisë ndonjë organizatë? Nëse po,cilat organizata dhe a dihet burimi i financimeve ?A është planifiku të ndërtohet me fonde të banorëve?Nëse po,a kanë dhënë pëlqim banorët për ndërtimin e xhamisë?A do të merr pjesë komuna me bashkëfinancim në ndërtimin e kësaj xhamie?Nëse jo,apeloj që Komuna ta ndaj një fond për ndërtimin e xhamisë.Në HZK,a lejohet ndërtimi i xhamisë në atë parcelë?Ne si LDK e mbështesim.

Laureta Tafaj - këtu e kam një letër të cilën e ka nënshkruar Kryetari i fshatit i cili mandatin e kaluar ka qenë iniciator për një kapellë dhe një xhami në të njëjtin vend.Këtu nuk kam nënshkrime të qytetarëve përveq Kryetarit i cili vet e ka bë këtë kërkesë.Nuk më duket e drejtë pa marrë pëlqimin e qytetarëve, ne me marrë një vendim në Asamble.

Armend Krasniqi - kërkesa është zyrtare, e formuluar në këshillin e fshatit.Në kuadër të asaj kërkesë, detyra jonë ka qenë që të gjendet një vend që është i përshtatshëm për atë lloj investimi të cilin dëshirojnë ta bëjnë qytetarët në atë fshat. Ne e kemi përgadit skicën të cilën ju do ta votoni ose jo.

Liridon Fandaj - në KPF ti më ke propozu me votu kundër xhamisë dhe ke thënë që e ke sjell kundër vullnetit tend.

Armend Krasniqi - në KPF konkretisht kam thënë që:Unë si individ,nëse më pyesin se a ka nevojë me u ndërtu një shkollë në Studenqan,unë them jo sepse s'ka nxënës.Këtu nuk ka lidhje individualiteti.Unë e prezantoj Drejtorinë për Katastër.

Selman Kolgeci - nuk e besoj që një drejtor me iu drejtu Asmblesë pa e kompletu dokumentacionin.Nuk është kërkesa në dokumentacion.

Kryetari - ne e kemi një kërkesë shumë të hershme të fshatit Shirokë.Është kërkesë për të cilën bashkësia islame ka kërku leje dhe ne për me qenë çdo gjë në rregull,kemi bë kërkesë për me nda parcelën.Nuk kanë

kërku donacion,kërkojnë lokacion edhe donatorët dalin në mënyrë publike dhe që kanë nevojë ne do ti ndihmojmë.

Flamur Bytyçi - ne jemi pro me votu por unë kam kërkesë që herave tjera kërkesat ti sillni të kompletuara.Ne duhet ta dime se nga vje financimi.Nësër ata mund të tërhiqen.A do ti financosh si Komunë?Ku do ti marrësh mjetet? Ky është shqetësimi im.

Kryetari - biznesi kur të konkurojë,konkuron për interesa të veta e kjo xhami dhe bashkësia islame nuk është për interesa të veta por për intresa të fshatit që kanë kërku me vite të tëra.Janë organet tjera që kërkojnë prejardhjen e parasë,nuk është Kryetari.

Urim Suka - shumica e zhurmave që u bë për projekt vendime në fjalë është për çështje teknike që ne i kemi ngritë edhe më herët.Këtë kërkesë që Drejtori ma dha,është dasht ta sillte në KPF dhe nga KPF-ja me iu shpërnda secilit asamblesist dhe ky vendim do të kalonte me 5 minuta kohë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

**23 për, 2 apstenime
Miratohet pika 3**

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për mbikqyrjen e zbatimit të kontratave për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të Komunës nga përfituesit;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Selman Kolgeci - a ka pas komision për vlerësimin dhe mbikqyrjen e zonës industriale në Shirokë dhe agrozonë deri tash?Nëse po,si ka qenë përmbajtja e tij?A ka raport të punës të deri tashme?Cilat janë të arriturat dhe dobësitë e raportit?Pse duhet të bëhet një komision prej Kuvendit dhe jo prej Qeverisë?Kush është përgjegjës për mbikqyrjen e këtyre kontratave?Pse përgjegjës në tuaj Kryetari pe delegon te anëtaët e Kuvendit?A ka statut zona idustriale dhe agrozona dhe a është e nevojshme me pas statut?

Kryetari - ka qenë një komision,e ka përfundu punën e vet.Ka pas fjalë se Kryetari po jep prona,po i jep prona kujt po don.Jeni organi më i lartë që merrni vendime dhe për të qenë transparent formoni komisionin,sjellni rekomandimet dhe unë do ta kryej punën.

Selman Kolgeci - të gjitha kontratat që unë i kam pas në dorë dhe i kam analizu,shënon që palët kontraktuese janë Komuna e Suharekës dhe operatorët ekonomikë.Nëse ka pas një komision,pse nuk e keni sjell raportin?Te kontrata,neni 7 thotë:qiradhënësi nuk ka të drejtë që parcelën e cila është lëndë e kësaj kontrate t'ia jep me qera apo në çfarëdo mënyre t'ia tjetërsoj qiramarrësit apo ndonjë personi tjetër juridik.Nëse merret një veprim që nga ana e Komunës bie ndesh me këto nene,a e rezikojnë mu fut në rrugë me të cilat përpos që del Koma humbës mund të rezultojnë edhe me pagesa të dëmshpërblimeve për operatorët ekonomikë,siq po ndodh tani. Në seancën e kaluar ky Kuvend e ka miratuar inicimin e planit rregullues të hollësishëm për zonën industriale në Shirokë.Si niset një plan pa e ditë se si është gjendja aty? Ne kemi pritë që këtë seance të na sillni raportin për zonen industriale me të dhënat se sa janë zbatu kontratat,sa është respektuar plani dinamikë,sa janë investimet që kanë realizuar operatorët ekonomikë në Z.I.,a është ndërruar destinimi në ndonjë parcelle etj.Ne si LDK nuk e mbështesim këtë pikë dhe nuk propozojmë emër për anëtar të këtij komisioni.

Dardan Berisha - komisioni për mbikqyrjen e zbatimit te kontratave për Z.I. në Shirokë dhe Agrozonën, unë mendoj që duhet me qenë profesional,qoftë prej ekzekutivit ose prej legjislativit.Në këtë rast ne si asamblesist të PDK-së nuk kemi propozim.

Aziz Bytyqi - sa i takon vendimit,disa seanca radhazi jemi akuzuar se po i ndajmë pronat vet dhe komisionet për ankesa po i shqyrtojnë ankesat e atyre që s'janë të kënaqur.Unë mendoj se ky vendim është në funksion të transparencës dhe marrjes së informacioneve direkte nga gjithësecili që ka interes dhe për të marrë përgjegjësi në vendimarrje.Komisioni po bëhet 3+2, po s'do të thotë që s'ka profesionist sepse në Kuvend ka jurist,inxhiniera të spikatur nga të gjitha gr. Politike.Ky komision e ka për detyrë të nxjerr rekomandime mbi shfrytëzimin e atyre pronave publike dhe në fund jep rekomandim për Kryetarin e Komunës.Pastaj është detyrë e Kryetarit të merr vendime me raportin e sjellë nga ky komision.Ju herë kërkonti të jeni pjesmarrës në vendimarrje dhe kur vjen mundësia me qenë pjesmarrës,nuk doni me

marrë përgjegjësi. Ju përgaditeni se kush kënd dhe si me sulmu e pastaj me plasu në opinion. Kështu nuk bëhet politika. Mos provoni të tregohi ata që s'jeni, se në fakt jeni shumë të mire. Të gjitha punët e mira i kemi bërë bashkë dhe do ti bëjmë bashkë edhe në të ardhmen.

Kryetari - nuk është asnjë prone që është diskutabile dhe që është dhënë prej viti 2018. Janë diskutabile pronat që janë dhënë prej momentit të parë e deri në vitin 2017.

Kryesuesi - ia jep fjalën zyrtarit ligjor për sqarime rreth pyetjeve të bëra nga asambleisti Selman Kolgeci.

Avni Bytyqi - ka komision të themeluar nga Kryetari i Komunës për mbikqyrjen e zonave. Zonat ekonomike nuk duhet të kenë statut për arsye se ligji për zonat ekonomike dhe udhëzimi administrativ nuk e obligon Komunën që të ketë statut, mirëpo e obligojnë Komunën që zonat ekonomike duhet të jenë të licencuara e fatmirësisht Komuna jonë i ka të licencuara dy zonat ekonomike.

Selman Kolgeci - çka ka ndodh, pse nuk ka legjitimitet ai komision? Pse rekomandimet e këtij komisioni nuk mundet me i zbatu Kryetari, nëse ka pas rekomandime. Ne po e bëjmë një komision pa e shfuqizu të mëparshmin. Azizi tha që kemi kërku me marrë pjesë nëpër komisione. Po, kemi kërku me marrë pjesë sikur edhe kërkojmë me i respektu komisionet që janë aktuale.

Kryetari - komisioni që është i krijuar prej Asamblesë për dhënien e pronave, vazhdon sepse e ka mandat.

Flamur Bytyqi - si e thanë dhe kolegët, edhe unë them që ne u dasht të kemi një raport të këtij komisioni për punën që e ka bë. Unë nuk pajtohem me u marrë me agrozonën në Samadraxhë për shkak se ju nuk keni ofru infrastrukturë atje. Ajo zonë është pa rrymë. Ky vendim është gabim. Ne nuk i raportojmë Kryetarit por i raportojmë Kuvendit. Unë jam për me marrë pjesë nëpër komisione mirëpo jo me na lënë hapsirë si opozitë vetëm në komisione ku po doni ju. Unë kam kërku me u themelu komitete për secilën drejtori. Pajtohem me ato që the, vetëm hajde ti bëjmë edhe ato që po themi ne.

Aziz Bytyqi - unë kam informacione se ajo zone nuk shfrytëzohet gjithmonë në bazë të kontratës dhe ndoshta është një ndihmë e jona nëse marrim pjesë dhe shohim praktikisht se si po veprohet. Nëse dikush nuk e shfrytëzon në bazë të kontratës, është keq kur dikush tjetër ka interes me shfrytëzu atë zonë. Unë informacione praktike nuk kam dhe pse mos me i ndihmu ekzekutivit dhe qytetarit sepse nëse nuk i kanë plotësu kushtet, i japim kohë me i plotësu kushtet në bazë të kontratës.

Flamur Bytyqi - unë isha pajtu me qenë pjesë e këtij komisioni nëse na kisht lënë hapsirë me qenë edhe në komisione tjera dhe me kërkesat tona. Ne e dime çka ka ndodhë, janë tjetërsu pronat, janë lëshu me qera.

Qëndrim Elshani - për deri sa nuk kemi pa ndonjë raport të komisionit, besoj që formimi i komisionit duhet të shtyhet sepse ligji është veqse në qeveri për zona ekonomike.

Shefket Kolgeci - unë mendoj që ky komision nuk ka nevojë të formohte nga Asambleja Komunale për deri sa është një komision që i ka vlerësu ato prona, kanë ardhë në Asamble janë votu. Andaj detyra e Kryetarit dhe e qeverisë komunale është ti monitorojë ato prona, ato biznese se si po funksionojnë. Kur e keni formu komisionin për prona nuk na keni dasht sepse ju kemi pengu dhe tani hajdi se keni përgjegjësi me na ndihmu. O duhet me marrë pjesë opozita në të gjitha komisionet ose në asnjë. Prandaj ky komision nuk duhet të formohet për mbarëvajtjen e atyre bizneseve dhe ne nuk do të marrim pjesë.

Kryetari - mandatin e kaluar ke qenë ti në komision dhe Elmaze Bytyqi është këtë mandat. Qëllimi im është me qenë transparent.

Shefket Kolgeci - kjo është kompetencë e Kryetarit dhe qeverisë komunale për mbarëvajtjen në këto zona.

Elmaze Bytyqi - unë jam vetëm në komision afatshkurtër për Arta Tex.

Kryetari - doktorr po befasohe dhe nuk po e din që ndryshojnë dhe komisioni prej komisionit është me rregullore.

Shefket Kolgeci - kur është formuar komisioni për ndarjen e pronave na ke mbivotu dhe për komisionin për ankesa na ke mbivotu dhe ska asnjë prej opozitës. Është hera e pare këtë mandate të juajin që keni komisione pa opozitën.

Urim Suka - doktorri është duke folë për fillimet e Asamblesë kur përgjegjësi ka qenë me formu një komision për një mandat katër vjeçar dhe ju nuk keni lënë anëtar as te komisioni për mi nda pronat dhe as te komisioni për ankesa. Pastaj ministria e ka ndryshu dhe tani nëpër disa komisione kemi anëtar edhe ne.

Kryetari - seancën e radhës dhe prej kur ka fillu, për çdo pronë që u dhënë ka mi sjell me emër dhe mbiemër ku ka marrë pjesë asambleisti LDK-së.

Urim Suka - unë kam respekt për Azizin dhe është e çuditshme që ju shefin tuaj e keni me më së paku kompetenca dhe e ndëgjoni më së paku. Aziz, është e vërtetë që unë përgatitem minimalisht dy javë. Nëse të duket teatër me shku në Greiqec dhe mi pa tri kontrata që ky pushtet i ka bërë dhe asnjë gjë sipas kontratave nuk ka shku. Vi e them këtu që të formojmë një komision për të vërtetuar atë që e kam thënë dhe ju e qoni dorën kundër. Ndarja e pronave është përgjegjësi e Kuvendit ndërsa implementimi i kontratave nga operatorët është përgjegjësi e qeverisjes tënde Kryetar por frika është e jotja për tu përball me realitetin atje. Komisioni të formohet dhe ta dimë gjendjen, por të gjithë e dim gjendjen dhe aq më tepër Kryetari e din edhe më mire se ne si është gjendja atje dhe asgjë nuk i duhet me i rekomandu ne. Gjendjen e dine spese me lejen e tij janë bërë ato gjëra dhe vetëm duhet me marrë vendime të bazura në ligj dhe të përgjegjshme, që nuk i merrë kurrë.

Kryetari - a të kujtohet si ka qenë zona para katër viteve? A e ka pas unazën dhe si ka qenë e ndërtuar? Mjetet që vijnë në Suharekë janë të qytetarëve. Unë i kryej punët e mia me ligj dhe rregullore. Zonat që janë dhënë në mandatin tonë janë në rregull.

Kryesuesi - me qenëse në këtë komision nuk po përfshihen të gjitha grupet e partive politike, unë e tërheq pikën 4.

Urim Suka - me faktin që ju e tërheqët pikën, i bie që të gjitha kritikrat tona janë me vend.

Pika 5. Njoftim i planit të zyrës së prokurimit për vitin 2023;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Flamur Bytyçi - është dashtë të jetë prezentë menaxheri i prokurimit.

Kryesuesi - e kam informuar menaxherin e prokurimit mirëpo kanë ardhë auditorët e jashtëm dhe menaxheri është duke ia kompletuar lëndët të cilat ata po i kërkojnë.

Urim Suka - kërkoj sqarime sa i përket planifikimit përfundimtar të prokurimit. 147.000 euro janë planifikuar për mirëmbajtje dhe pastrim të rrugëve. A mund të specifikoni se çka do të bëhet me këto rrugë? Për çfarë mirëmbajtje është fjala dhe për cilat rrugë? 115.200 euro janë planifiku të shpenzohen për shërbime këshilldhënëse për legalizim dhe nuk po kuptoj pse duhet kaq shumë mjete për shërbime këshilluese për legalizim. 150.000 euro i keni planifiku për rrethojat e ndërtimeve urbane, ku shkruan objektet komunale dhe shkollat: 7 marsi, Jeta e Re dhe Shkëndija. Çudia e kësaj për mua është që një Kryetar i juaji i kishte hequr rrethojat e komunës e tash po doni me i vendos. Çudia tjetër është që shkollat rrethojat i kanë. Për mua është e pa kuptueshme.

Enver Shabani - është e vërtetë që mbledhjen e fundit në KPF kemi mungu dhe sqarimet na takojnë ne si drejtori që ti japim dhe ndoshta në këtë rast nuk ka pas nevojë me qenë Fatosi sepse Fatosi i shkojnë pothuaj të gatshme dhe të pëgatitura nga drejtoritë e veqanta dhe specifike. Ai e ka obligim ti menaxhojë dhe ta bëj hapjen. 147.000 euro ne i kemi dediku për patsrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve, shesheve, varrezave, lapidarëve dhe të gjitha hapësirave publike që menaxhon K.K. Suharekë.

Visar Kuçi - shërbimet këshilldhënëse janë për legalizim në mungesë të stafit të D. Urbanizmit. I kemi kërku 12 eksperta dhe prej tyre 10 kanë aplikuar. Kontratat janë 2 vjeqare. Sa i përket rrethojave urbane, e dini dhe ju që ka qenë premtim i Kryetarit të Komunës dhe do ta realizojë.

Urim Suka - nëse është dy vjeqare, mua prap më duket shumë.

Visar Kuçi - Komuna e Prishtinës me miliona euro ka nda buxhet, ndërsa K. Prizrenit 30 i ka marrë.

Urim Suka - shkollat janë të rrethuara dhe ju doni të bëni rrethoja prap. Shkollat kanë probleme plot dhe ato mjete dërgoja shkollave ku kanë nevojë. Nëse s' e mbani këtë premtim askush nuk ju akuzon.

Enver Shabani - te shërbimet këshilldhënëse kemi bërë kërkesë edhe për inxhinier të elektros, të hidros dhe një për eficiency por fatkeqësisht nuk është lajmëruar asnjë.

Flamur Bytyçi - në bazë të planit të prokurimit për vitin 2023, shumica e aktiviteteve të prokurimit planifikohen të fillojnë në mars 2023. Sa është realizuar plani i prokurimit deri tani kur dihet se mos realizimi i planit të prokurimit ka ndikim të drejtëpërdrejtë në realizimin e projekteve. Po ua rikujtoj që vitin e kaluar ju keni nxjerr vendime të jashtëligjshme për bartje të mjeteve, prej një projekti në projektin tjetër dhe që konsiderohet si keq menaxhim i parasë publike. Kërkoj sqarime.

Enver Shabani - për tre mujorin e parë përafërsisht kemi shku 10 % deri tash në zyrë të prokurimit dhe kemi fillu të nënshkruajmë kontrata të reja për këtë vit. Drejtori tutje jep sqarime.

Selman Kolgeci - unë mendoj që është shumë e nevojshme të jetë prezent menaxheri i prokurimit dhe mendoj që këtë pikë duhet me shty për një seancë tjetër. Ka sjell një raport të planifikimit se si ka vlerësu me i zhvillu procedurat por dua të di se ky planifikim a është në harmoni me buxhetin e miratuar për vitin 2023. Për sa nga procedurat në këtë planifikim i kanë sjellë projektet detale apo pjesa më e madhe po realizohet me paramasa të koncentrueme për me ndiku në përcaktuesin e fituesit të tenderit. Në këtë plan të prokurimit është planifiku ndërtimi i objektit të Kuvendit Komunal në Suharekë .A do të thotë që përfundimisht kanë heq dorë nga ndërtimi i objektit të Komunës dhe tani po e bëjnë vetëm objektin Kuvendit të Komunës apo këto dy terma nuk po din ti dallojnë. Kërkoj që këto dy pika sa i përket zyrës së prokurimit të shtyhen në një seancë tjetër.

Festë Kabashi - kolegu Urim Suka më duket e kontestoi pjesën se a ka nevojë të investohet te tri shkollat e qytetit, por unë po precizohem te shkolla Shkëndija dhe ajo jo vetëm që ka nevojë për rrethoja por ka nevojë emergjente për gjithëçka. Me qenëse e ke bë praktikë me dalë në teren, gjë që e vlerësoj, të ftoj që bashkarisht ta shohim gjendjen e asaj shkolle.

Urim Suka - me shumë dëshirë e pranoj ftesën. Unë fola vetëm për rrethojën sepse shkolla Shkëndija e ka rrethojën dhe nëse e ka të demoluar, bën me renovu. Unë mendoj që nëse shkollat kanë rrethoja, më mire ato pare me i investu në gjëra tjera e jo në rrethoja.

Pika 6. Raporti i punës për zyrën e prokurimit për vitin 2022;

Kryesuesi - hap debatin për këtë pikë.

Selman Kolgeci - nëse e gjejmë mbështetjen e gjithë kolegëve, ne do të provojmë të thërrasim për seancë të jashtëzakonshme për këtë dhe raportimin e zyrës së prokurimit për vitin 2022 dhe 2023. Ne po i shpalojmë vërejtjet që i kemi por s'po kemi kujt sepse nuk është as Kryetari dhe as menaxheri i zyrës së prokurimit. Për raportin e prokurimit për vitin 2022 asnjë ndryshim dhe asnjë progres në zyrën e prokurimit. Vitin e kaluar në top 10-she e këtë vit përsëri në top 10-she por jo për të mirë. Jemi në top 10-she të autoriteteve kontraktuese ndaj të cilave është ushtruar ankesë nga operatorët ekonomikë për vlerësime të tenderave. Sipas vendimeve të bordit të OSHP-së shumica e vendimeve që nxjerr zyra e prokurimit të K. Suharekë rrëzohet nga ky organ dhe kjo është një tregues i qartë i paaftësisë dhe tregues i qartë i ndërhyrjes politike në vendime për dhënie të kontratave. Si pasojë e këtij keqmenaxhimi të zyrës së prokurimit janë zgjat procedura për shumë projekte të rëndësishme për qytetarët vetëm që të shpërblehen me kontrata njerëzit e afërt me pushtetin. Kjo ka ndodh në shtëpinë e kultures "Ukë Bytyqu", në rrugën "Skënderbeu" e shumë projekte tjera. Vitin e kaluar kemi miratuar një strategji për integritet të Komunës në të cilën mes tjerash është planifikuar se çfarë duhet të ketë zyra e prokurimit për secilën faze të procedurave të prokurimit. Pse nuk po zbatohet ajo strategji? A është zbatu komplet planifikimi i prokurimit për vitin 2022? Dua të diskutoj për rrugë tjera që kanë qenë vitin e kaluar, janë pagu dhe prapë janë në listë për zhvillimin e procedurave për lidhje të kontratës. Po ashtu janë disa projekte të cilat kanë qenë në listë të projekteve për vitin 2022 por nuk janë udhëheq procedurat. Unë kisha thënë që mos ti kalojmë këto dy pika.

Kryesuesi - ne jemi një Komunë e mesme por për fat të mire në Komunën tonë ka shumë operatorë që operojnë në biznese për ndërtim të rrugëve e lloj tjetër biznesesh. Për këtë është një lloj lufte mes bizneseve që secili me marrë një punë. Për atë kemi lëndë në OSHP. Sa i përket pjesës se sa janë zbatu kontratat që kalojnë përmes zyrës së prokurimit, janë zbatu afërsisht 98%.

Selman Kolgeci - nuk është problemi pse ankohen sepse është e drejtë e tyre. Por pse po rrëzohen vendimet që po i merr zyra e prokurimit?

Urim Suka - në këtë raport shkruan: për ndërtimin e rrugëve: Rexhep Velia, Shaljanët, Molika etj. në Mushtisht, janë shpenzuar 72.000 euro por këto rrugë nuk janë shtruar fare. Në këtë raport shkruan se për ndërtimin e rrugëve: Emërllah Hoxha. Kolonja dhe 13 Korriku në Peqan janë shpenzuar 24.000 euro por asnjëra nga këto rrugë janë shtruar. Për ndërtimin e rrugëve në lagjen Boka, Hajriz Xhema dhe 8 vëllezërit në Greiqec janë shpenzuar 30.000 por rrugët nuk janë shtruar. Për rrugët në Javor janë paguar 18.000 euro

por rrugët nuk janë shtruar atje.Për rrugë në Greikoc janë shpenzuar 50.000 euro dhe rrugët që janë në raport nuk janë të shtruara.Në këtë raport thuhet se janë shpenzuar 185.000 euro për sanimin e ndriçimit publik dhe problemet me ndriçimin publik janë gjithëandëj e shumë shembuj të tjerë që figurojnë në këtë raport e që në teren nuk kanë ndodhur.Unë dua ti bëj tri thirrje publike nga kjo foltore.1. Është thirrje publike për të gjithë ata persona që e kanë përgjegjësi ta kontrollojnë këtë mënyrë të parasë publike që të të dëgjojnë zërin tim e të vine të shohin e ndalojnë këtë logjikë të mbrapshtë qeverisëse.2.Është thirrje miqësore për të gjithë ju kuvendar që jeni pjesë e kualicionit qeverisës.Ju ftoj të ngritni zërin para meje e të provoni ta ndalni e ndryshoni këtë model të mbrapsht qeverisës që tashmë edhe vet jeni në dijeni.3.Ftoj secilin qytetar të Therandës ta shoh e dëgjoj fjalën time për të pare e kuptuar logjikën e kësaj qeverisje e cila ka instaluar në Komunën tone.Dua të theksoj që ky raport që ju vet keni hartu,tregon të vërtetën e pushtetit tuaj dhe si i tillë ky raport e kjo qeverisje nuk kalon.

Enver Shabani - Urim,të gjitha ato që përmende,si Mushtishti,Peqani Greikoci,Javori,ndriçimin publik etj.,është e vërtetë që janë shpenzu ato mjete dhe është e vërtetë që një pjesë e rrugëve janë të shtruara dhe është e vërtetë që një pjesë e disa rrugëve nuk janë të shtruara por që kontrata është dy vjeqare.Andaj ju ftoj për durim deri nga fillimi i qershorit dhe besoj që përmbyllen kontratat.Andaj mos ti dezinformojmë qytetarët. Për ndriçimi publik është e vërtetë që është një kontratë dhe është e vërtetë që janë hargju ato mjete por mos harro se i kemi 170.000 kilometra ndriçim publik.

Urim Suka - këto që i fola unë s'po i besoni.Formone komisionin dhe shkojmë i shohim.Ndriçimi publik nuk bën në Bllacë,Samadraxhë,Doberdelan,Studenqan dhe problem është që tre vitet e fundit i keni vendos këto të rejat dhe askund nuk i ke funksionale. Kontrata për mirëmbajtje është 250.000 dhe në Duhël është gropa ku aty mund të bëhen aksidente.

Enver Shabani - kemi bë intervenime të ndriçimit publik e sidomos në Bllacë,por me ardhjen e vendimit të qeverisë për kursimin e emergjisë elektrike,ne kemi qenë të obliguar të marrim vendim ku në shumicën e njehsorëve kemi vendos sensorët dhe në orën 11 fiken dritat.Drejtori tutje jep sqarime.

Flamur Bytyçi - në bazë të këtij raporti pashë që janë 17 ankesa të operatorëve ekonomikë dhe 8 prej tyre janë kthyer në rivlerësim.Dy prej tyre janë ndërtimi i Kolektorit dhe shtëpia e kulturës.Në këtë raport është ndërtimi i rrugës Emërllah Hoxha,Kolonja,13 Korriku dhe rrugë tjera në fshatin Peqan.Është edhe ndërtimi i infrastrukturës së ujësjellësit dhe gjendja në teren nuk e thotë që është ndërtu ose është punu në ujësjellës.

Enver Shabani - për investimet për ujë në Peqan problemi është te vet qytetarët.Qytetarët kanë ujë mjaftueshëm por nuk janë të interesuar me i vendos njehsorët.Kemi bërë përpjekje por nuk janë pajtu. Sa i përket emrave të rrugëve është kodi që nuk kemi të drejtë me i ndryshu,andaj përcillet si kod.

Flamur Bytyçi - është një kontratë për mirëmbajtjen dhe sanimin dhe rrjetin e kanalizimit dhe kontrata e pare është 247.000 euro dhe kontrata e dytë është 261.000 euro.A mund të na sjellësh raportin dhe me na njoftu se ku është punu në këto vlera.

Enver Shabani - po.Kanë qenë dy kode dhe kanë qenë dy kompani që kanë punu.Njëra mbi rrugë dhe tjetra nën rrugë.Në shumicën e fshatrave kemi bërë investime por puna e kalazimit do kohë për tu realizu.

Flamur Bytyçi - te kontrata llot 6 është ndërtimi rrugës Martirët e Lirisë në Semetisht por kjo rrugë nuk ekziston në fshatin Semetisht.Edhe rregullimi i fshatit të lumit në Semetisht nuk është bërë.Gjithëashtu ndërtimi dhe rregullimi i rrugës Ukë Bytyçi nuk është bërë dhe pagesat janë bërë.

Enver Shabani - në Semetisht shtratin e lumit e kemi shtru me beton kurse rrugë tjera janë punu por me emra nuk mund ti mbaj mend të gjitha.

Flamur Bytyçi - nuk janë të shtruara asnjë prej këtyre rrugëve që janë cek në raport.

Enver Shabani - është e rëndësishme se këto para nuk janë keqpërdor dhe nuk janë vjedhë por metrat katror çfarë kanë qenë të planifikuara,janë në të njejtin fshat.

Flamur Bytyçi - për cilën do rrugë që po përmendet,ne duhet ta kemi një specifikacion se ku është ndërtu ajo rrugë ose duhet me ndryshu emrin se ku është investu.

Enver Shabani - raport ka për secilën rrugë që është shtru.Pa u bë një raport nuk mund të bëhet pagesa.

Flamur Bytyçi - kanalizimi në Semetisht është i pa përfunduar dhe punimet janë ndërpre.

Enver Shabani - nuk e di pse,përndryshe një sanim të kanalizimit e kemi bë në Semetisht këto ditë.

Liridon Fandaj - dy here keni nda mjete bashkë me Hidroregjionin dhe nuk ia keni dërgu ujin qytetarëve. Të kam thënë dhe në dëgjim publik, që nëse ju e dërgoni ujin, orëmatësat unë i vendos dhe ju prap fajin ia leni qytetarëve. Nuk e di si po i bëni pagesat kur rruga Emërllah Hoxha është shtruar në vitin 2020.

Enver Shabani - Komuna e ndan me bashkëfinancim për Hidroregjionin dhe fshatin ku ka nevojë të investohet për ujë. Ti the po keqmenaxhohet por ne nuk e menaxhojmë ujin por nëse keqmenaxhohet, keqmenaxhohet nga hidroregjioni ose nga vet qytetarët e fshatit Peqan kurse rruga Emërllah Hoxha ka mbet kodri por nëse shohim raportet e këtij viti nuk ekziston që është shtruar ajo rrugë sepse është shtru rrugë tjetër.

Liridon Fandaj - pagesa si është bë?

Enver Shabani - pagesa bëhet sipas rrugës që është shtruar.

Liridon Fandaj - mua si qytetarë më intereson të kem ujë por ti nëse taksat e mia ia jep një kompanie dhe nuk e mbikqyr, përgjegjësia e kujt është kjo?

Enver Shabani - rrjeti i ujit në Peqan është i shtrirë dhe problemin e ujit duhet me zgjidh vet qytetarët.

Liridon Fandaj - Pse ndani mjete dhe nuk i mbikqyrni ato projekte?

Enver Shabani - thashë që jemi të gatshëm me bashkëpunu kur ju jeni të gatshëm.

Vullnet Luzhnica - kam replikë me z. Suka i cili përmendi rrugët e Javorit, për shkak se vi nga ai rajon. Rruga Osman Dalipi është përfunduar vitin e kaluar, rruga Hafir Gashi është dy vjeqare dhe pritet të mbyllet këtë vit. Janë edhe 1550 m rrugë pa shtru por mos e harro një fakt që ka q shumë metra rrugë që për 11 vite qeverisje të LDK-së nuk ka pas asnjë investim capital që veqohet. Nëse ke një për zonën lartë, të ftoj ta publikosh.

Urim Suka - shkojmë bashkë, i marrim kontratat dhe nëse diçka prej tyre që kanë thënë s'është e vërtetë, unë mbaj përgjegjësi për atë që e kam thënë.

Vullnet Luzhnica - pajtohem që të shkojmë bashkë dhe ti shohim kontratat.

Selman Kolgeci - para disa seancave kemi kërku nga ky Kuvend që të fillojë ta implementojë projektin për adresat dhe emrat e rrugëve. Ju përpos që nuk i keni shty përpara iniciativën tonë, keni dalë dhe keni thënë që kjo nuk bëhet, duhet të presim 10 vite. Rregulloi adresat dhe nuk ke me pas më kurrë atë problem. Unë e di që për buxhetin e viti 2023 ekziston fond për emrat e rrugëve dhe në planin e prokurimit është pasqyru prej buxhetit. Te çështja e raporteve të kontratave jam i lumtur që ka raport të kontratave. Ta kam kërku komplet listen e investimeve kapitale për vitin 2022 së bashku me raportet, me situacionet por ju ma keni sjell listen çka është investu por jo të kompletuar.

Pika 7. Pyetje dhe përgjigje

Flamur Bytyçi - Pyetje për Drejtorin e Financave. Ju e keni nënshkru një marrëveshjen me Postën e Kosovës për shpërndarjen e faturave të tatimit në prone. Pse s'janë shpërnda faturat deri më sot? Kemi ankesa prej qytetarëve. Gjatë viti të kaluar keni pas të hyra më pak se vitin që lëmë pas. Pse s'po merrni masa ndaj bizneseve që si kanë paguar detyrimet?

Labinot Halitjaha - po, ne e kemi një marrëveshje me Postën E Kosovës për shpërndarjen e faturave. Faturat e bizneseve janë shpërnda ndërsa faturat e tatimit në pronë akoma nuk janë shpërnda. Këtë problem e ka Posta dhe ne kemi kontakti dhe është problem i tyre i brendshëm. Nëse nuk shpërndahen me kohë Posta do të ketë ndëshkim. Sa i përket të hyrave që ka pas vitin e kaluar e kemi diskutu shumë herë. Për pjesën në përmbartim, do të fillojmë me vërejtje për bizneset që kanë borgje ndërsa për pjesën e tatimit në pronë, pa u shpërnda faturat dhe me pas një kohë qytetarët, nuk mund të marrim veprime.

Flamur Bytyçi - Te marrëveshja që e keni me Postën e Kosovës, a keni caktu afate kohore?

Labinot Halitjaha - nëse bëhet vonesa e shpërndarjes së faturave të tatimit në prone, ne do të kërkojmë ta shtyjme afatin e ankesave.

Flamur Bytyçi - Pyetje për Drejtorinë e Kulturës. Ka ndodh e dyta here që thirrjet për subvencione nuk i publikon fare ose i publikon me vonesë kur dihet që shumica e klubeve kanë fillu aktivitetet e tyre dhe i duhet përkrahje nga Komuna.

Lorika Gashi - subvencionet nuk kanë afat kohor në të cilin ligjërisht duhet të vendosen. Shumica e klubeve kanë fillu mi mbajtë aktivitetet dhe kur të subvencionohet, ajo llogaritet në raport 1 vjeçar sepse është projekt i gjithë vitit. Subvencionet do të dalin në muajin prill.

Urim Suka - Pyetje për Kryetarin e Komunës. Këto ditë jam interesuar për tu informuar me pagesat që ju keni bërë për portalet lokale e qëndrore për të shpërndarë propagandën tuaj. Kam arritur të gjej pagesa të rregullta mujore për dy portale që ju keni bërë. Një portal lokal dhe një me adresë në Prishtinë i cili është i panjohur për publikun në Suharekë. Pse është dashur të bëni pagesa të rregullta mujore e të shpenzoni taksa komunale për një portal me adresë në Prishtinë ku interesi publik është që të informohen qytetarët në Suharekë? Cila procedure është ndjek për zgjedhjen e këtij portali? Portali është "Ballkani info". Kërkoj nga zyra e Kryetarit që të më përgaditni një raport me të gjitha pagesat që janë bërë me qëllim reklamimi nga zyra juaj, përkatësisht emrat e portaleve që ju keni bërë pagesa dhe shumën e pagesës për secilin portal gjatë viti 2022. Gjithëashtu kërkoj listen e përfituesve të të gjitha llojeve të subvencioneve që janë dhënë nga zyra e Kryetarit, përkatësisht emrat, shumën dhe arsyen e përfituesve. Pyetje për Drejtorin e Bujqësisë. Besoj që jeni informuar që nga fundi i muajit dhjetor të vitit 2022, një fermeri në fshatin Bllacë, hajnat i kanë vjedhë bagëtinë dhe ku dihet fakti se ky fermer të hyrat e vetme i ka nga kjo veprimtari. Dëmi është i konsiderueshëm dhe ky rast i ka shkaktuar shumë vështirësi për të përmbushur nevojat e tij elementare të funksionimit të mëtejshëm. Sipas informative që unë kam, fermeri në fjalë ka bërë dy kërkesa për mbështetje nga Komuna por sa di unë deri tani nuk ka marrë përgjigje. A e keni vizitu këtë fermer pasi keni kuptuar për dëmin që iu ka shkaktuar? A do të përgjigjeni pozitivisht kërkesave të tij duke i dalë në mbështetje për ti zbutur sa do pak dëmin e madh financiar? Kërkoj nga ju që ti merrni të gjitha veprimet e mundshme ligjore që ti japim mbështetje fermerit në fjalë dhe nëse të duhet mbështetja jonë, do ta kesh.

Kryesuesi - sa i përket pyetjes rreth pagesave të portaleve, unë do ta adresoj pyetjen te Kryetari.

Ardian Kotorri - jam i shqetësuar për situatën që ka ndodhë. Ka ndodh edhe në lokacione tjetëra. Fermeri ka ardhë ka ardhë disa here te unë dhe e kemi njoftu për mundësitë tona për me mbështet, megjithëse është e vështirë. Ministria nuk i mbështet këto forma por megjithëatë ne kemi një kod të subvencioneve dhe nëse na mbetet një buxhet në këtë drejtim, natyrisht që do ta mbështesim. E kam dhe një rast tjetër, i cili është Murat Kabashi në Krushicë, ku kam qenë dhe e kam vizitu. Drejtori tutje jep sqarime.

Urim Suka - unë nuk e di për rastin tjetër në Krushicë dhe raste tjera por në rastin që po flas unë, është emergjente me vepru dhe me i ndihmu. Mundësi ligjore ke dhe duhesh me vepru menjëherë.

Ardian Kotorri - alternativa me vepru ashtu nuk është e lehtë. Bëhet një komision dhe i shqyrtojmë ato ankesa. Prej 350.000 eurpe që i kemi në drejtori, një shumë të caktuar do ta dedikojë për këto problem.

Urim Suka - para dy muajsh e kam ngrit një temë te drejtorja e Arsimit dhe ende s'kam marrë përgjigje. Ju lus t'ja përcillni sepse janë dëmtu shkollat me buxhet dhe nuk e di se nga kanë shku ato pare.

Selman Kolgeci - në planin e punës së Kuvendit për vitin 2023, për muajin mars është planifikuar edhe raporti i punës dhe aktivitetëve të komisionit komunal të aksionerëve të Stacionit të autobusave dhe raporti i punës së Kryetarit për vitin 2022. Kryetari e ka obligim ligjor me i raportu Kuvendit një here në vit. Pse nuk ka ardhë me raportu? Kryesues, ju si epror i stacionit të autobusave është mire që seancën tjetër të raportojnë edhe pse e dime për shumë problem që kanë ndodhë atje. Pyetje për Drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Drejtorinë e Financave. Kam marrë shqetësime prej qytetarëve lidhur me orarin e punës së barnatoreve. Kërkoj ta bëni një rregullore komunale dhe të vendoset orari i barnatoreve që kujdestarojnë 24 h. Ftoj Drejtoreshën e Inspeksionit dhe të Shëndetësisë me e respektu atë rregullore dhe të bëhet publik orari se cilat barnatore po kujdestarojnë. Pyetje për Drejtorin e Sh.Publike. A ka Komuna dokument të vlerësimit të rrezikut si një dokument bazë për ballafaqimin me fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi tjera sipas udhëzimit administrativ ku obligohen Komunat me pas këtë dokument. Sipas informatave që kam, është e vetmja Komuna e Rahovecit që e ka një dokument të tillë. Sipas udhëzimit 01.2022 për norma teknike për mbrojtje nga zjarri të infrastrukturës ekektroenergetike dhe paisjeve për ndërtimet e larta që po ndodhin në Komunën tone. A janë të paisura nga inspektori i emergjencave duke marrë leje nga drejtorja përkatëse në kushtet ndërtimore dhe a kanë pëlqim paraprak nga emergjencat.

Kryesuesi - sa i përket raportit të komisionit, unë kam bisedu me anëtarin e komisionit dhe shpresoj muajin e ardhshëm vje raportit. Sa i përket raportit të Kryetarit, ai seancën e ardhshme është këtu dhe besoj do ta jep një raport.

Enver Shabani - Komuna e Suharekës e ka një plan të vlerësimit të rrezikut dhe të menaxhimit të situatave të jashtëzakonshme por që do një rividim dhe është e vërtetë që jemi në procedurë. Kemi kontakt me kompaninë që ka punu në Rahovec dhe I ka kërku 50.000 euro, gjë që nuk kemi qenë të gatshëm këtë vit me i nda sepse nuk kemi as as kod në vlerësimin e rrezikut në këtë nivel. Drejtori tutje jep sqarime sa i përket pyetjes. Sa i përket inspektorit të parandalimit të zjarreve, se a i pajis me leje objektet e larta, po i pajis të gjithë ata që bëjnë kërkesë dhe të gjithë ata që marrin kushtet për ndërtim në urbanizëm sepse ne e kemi obligim dhe nëse i plotëson të gjitha kriteret, pajiset dhe me pëlqim. Ne japim pëlqim edhe për mjedis. Koma e Suharekës ka ndërtime të larta shumë por Komunës i mungon një automjet me platforma ose shkallë hidraulike që i ndihmojmë zjarrëfikësit dhe nëse eventualisht ndodh një zjarr në katet e larta, ti evakuojmë ose ti nxjerrim banorët nga ajo pjesë.

Selman Kolgeci - ju potencuat që ka qenë një kompani. Unë nuk njoh një kompani që e harton këtë projekt dhe as një gjë tjetër, sepse e lidhet edhe me vlerën. Ju lutem mos e keqkuptoni në këtë drejtim. Ajo që më ka interesu mua, kur kam dëgju për një plan të tillë në K. Rahovec kam mendu që është e nevojshme dhe në atë dokumentacion besoj që përfshihet edhe çështja e kamionit me shkallë e platformë.

Enver Shabani - nuk keqkuptova por u mindova me qenë transparent.

Avni Bytyqi - ekziston një rregullore e vitit 2008 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës. Është rregullore e mire dhe praktike mirëpo sa është duke u zbatu në teren, mbetet të shihet. Organet të cilat e kanë për obligim ta zbatojnë këtë rregullore është policia e Kosovës dhe Drejtoria e Inspeksionit.

Labinot Halitjaha - ne e kemi pas një kërkesë prej barnatoreve që mos me punu të gjitha barnatoret të dielën por me ni teren me punu një barnatore, dhe në një teren një tjetër. Sa i përket 24 orë punë, e ka marrë për obligim Labinot Sopa të punojë. Drejtoria jonë nuk mund ta përcaktoj me ligj kush dhe sa duhet të punojë. Në këtë rregullore nëse mundemi me fut edhe në këtë rregullore që duam ta ndryshojmë dhe me përcaktu se cila barnatore duhet me punu 24 h në javë.

Liridon Fandaj - dy vendime i ke sjell. Një e ke tërheq në KPF dhe një në Kuvend Komunal, ku njëri është në Duhël e tjetri në Shirokë. Çka ke bë me ato vendime sepse ata nuk kanë kontest gjyqësor por janë uzurpatorë. Kur do të dalësh ti tërheqësh ata uzurpatorë prej pronës publike. Ata që i shfrytëzojnë lokalet komunale nuk paguajnë tatim në pronë por edhe i kanë lëshu lokalet me qera. Ku do t'ia shkëputësh kontratën atyre.

Armend Krasniqi - që nga ardhja ime në Drejtorinë e Pronës nuk ka ndodhë dhe as nuk guxon me u mendu me ndodhë asnjë uzurpim i vetëm.

Liridon Fandaj - nuk të amnistion ligji për diçka që ti e menaxhon dhe nëse diçka ka ndodhë dhe ti nuk merr veprim.

Armend Krasniqi - sipas disa hulumtimeve të cilat i keni bërë ju në të kaluarën, kryesisht i ka udhëheq komisioni juaj. Në suharekë rezultojnë rreth 1085 uzurpime. Unë me 1085 persona s'mund të shpalli luftë. Le të merret presidenti, Kryeministri. Ejani bashkarisht po e bëjmë një formulim dhe po vendosim me i rrëzu 1085 shtëpi në Suharekë. Kjo çështje është problematike.

Liridon Fandaj - ti duhet me marrë vendime dhe me rrëzu kontrata.

Armend Krasniqi - për çdo objekt dhe çdo lokal që ka pranim teknik jemi duke u marrë me regjistrim.

Liridon Fandaj - nuk mora përgjigje për ato dy vendime dhe ata që e shfrytëzojnë pronën publike dhe nuk i kanë kry obligimet.

Armend Krasniqi - ti vet ma ke bë pyetjen disa here në të kaluarën dhe ke kërku që ta bëjmë një komision për zonën industriale dhe për të gjithë ata që nuk i përmbahen kontratave, t'ia shkëpusim kontratat. Sot po të vje mundësia dhe nuk po pranon.

Liridon Fandaj - ai ka nënshkru kontrata të pa ligjshme, ai i ka fut bizneset me investu në zonë industriale dhe sot do me ia lënë përgjegjësinë Kuvendit Komunal që me u marrë me ta.

Liridon Fandaj - pyetje për Drejtorinë e Inspeksionit. Kur do me i liru hapsirat publike që janë të uzurpuara dhe cilat janë masat që do ti merr drejtoresha për ndërtimet pa leje?

Albulena Kokollari - ne jemi duke punu me inspektorat dhe shumë shpejt do të bëhet. Sa i përket ndërtimeve pa leje, ne si drejtori nuk kemi shumë kapacitet për me e përballu komplet territorin e Komunës së Suharekës. Ne me një inspektor të ndërtimit jemi duke u mundu me bë mbikqyrjen e

ndërtimeve pa leje dhe të atyre me leje. Unë nuk jam në dijeni që ka ndërtime pa leje dhe nëse keni, ju ftoj për bashkëpunim.

Shefket Kolgeci - shpreh një shqetësim të qytetarëve dhe jemi dëshmitar që kalojmë me makina për mes sheshit te ai ujëmbledhësi ku bëhet shumë zhurmë dhe kërkoj nga drejtori i Shërbimeve Publike që të sanohet.

Jehona Rrafshi - e dim që është një staf i vogël i zjarrëfikësave dhe disa kontrata mbi vepër vetëm kanë skaduar te zjarrëfikësat. A do të ketë numër më të madh të zjarrëfikësave ose te kontratës mbi vepër siq ka qenë më herët.

Enver Shabani - doktorrit po i premtoj përpjekje maksimale që deri në Asamblenë e ardhshme ta bëjmë sanimin e ujëmbledhësit. Sa i përket pyetjes së z. Rrafshi, ke të drejtë sepse është numri i vogël i zjarrëfikësave. Me ligj dhe me rregullore është e paraparë një zjarrëfikës për 1500 banorë dhe ky numër nuk i afrohet as përafërsisht njesisë zjarrëfikëse në Suharekë e që i ka 13 aktualisht. Këtë vit ne do të bëjmë përpjekje maksimale që ti marrim 6-8 zjarrëfikës.

Takimi përfundoi: 13:20

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj